



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 1433/3 prot.

Tiranë, më 7.06.2024

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informim, me e-mail datë 27 maj 2024, ora 11:01 pm

Z. T H

Lagjja nr. , rruga "M . T ", pallati nr. , D  
Të dhënat e kontaktit: e-mail: @gmail.com; Cel.:

**I nderuar z. H**

Në vijim të kërkesës suaj për informim, datë 27 maj 2024, ardhur përmes e-mail-it të koordinatorit për të drejtën e informimit dhe protokolluar me tonën nr. 1433/2 prot., datë 28.05.2024, ju sqarojmë se Rregullorja për Veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (miratuar me vendimin nr. 2, datë 19.07.2017, i ndryshuar) përcakton rregullat dhe procedurat që zbatohen për ushtrimin e veprimtarisë së këtij institucioni.

Neni 31 i kësaj rregulloreje trajton të drejtat e palëve për t'u njohur me materialet e dosjes, por edhe kufizimet, duke respektuar parimet dhe kriteret e përcaktuara në dispozitat ligjore në fuqi.

Komisioni në pikën 2 të nenit 31 të kësaj rregulloreje ka përcaktuar në mënyrë të përgjithshme materialet, të cilat duhet të jenë konfidenciale (materiale të cilat kanë karakter të brendshëm dhe që nuk lidhen me hetimin administrativ, provat e administruara apo vendimmarrjen dhe aktet administrative që nxirren nga ky institucion në zbatim të ligjit nr. 84/2016).

Materialet të cilat konsiderohen konfidenciale përcaktohen rast pas rasti nga Komisioni, relatori dhe trupi gjykues i çështjes, sipas fazave përkatëse të procesit administrativ ku ndodhen.

Gjithashtu, neni 47 i ligjit nr. 84/2016 ka përcaktuar të drejtat e palës gjatë procesit të rivlerësimit, duke iu referuar neneve 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative "Të drejtat e palëve gjatë procedurës administrative".

REKTAR I PËRGJITHSHËM  
Edmond Vercani  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT